



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1387/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Suma Engineering Platformë” d.o.o, me seli ne rr.”Pokornoga” 9, 10000 Zagreb Republika e Kroacisë, identifikuar sipas numrit te biznesit OIB 73369220751 te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Hoxha avokat nga Prishtina, ndaj debitorit “Bechtel Enka-GP O.P” me numër identifikues Unik 810897712, numër te biznesit 70658755 dhe numër fiskal 600455324, me seli ne rr.”: Mujo Ulqinaku” 5/9 Lagja Pejton 10000 Prishtinë, e përfaqësuar nga drejtori Riyadh Alkhazraji dhe menagjeri Ibrahim Karaagaç te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Nushi avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1609/19 dt.16.12.2020, me datën 17.05.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit “Suma Engineering Platformë” d.o.o, me seli ne rr.”Pokornoga” 9, 10000 Zagreb Republika e Kroacisë identifikuar sipas numrit te biznesit OIB 73369220751 nga ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1609/19 dt.16.12.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1609/19 dt.16.12.2020, ne pjesën I te dispozitivit, shpallet jo kompetentë ne pikëpamje lëndore për te vendosur sipas propozimit te kreditorit “Suma Engineering Platformë” d.o.o, me seli ne rr.”Pokornoga” 9, 10000 Zagreb Republika e Kroacisë, identifikuar sipas numrit te biznesit OIB 73369220751 kundër debitorit Bechtel Enka-GP O.P” me numër identifikues Unik 810897712, numër te biznesit 70658755 dhe numër fiskal 600455324, me seli ne rr.”Mujo Ulqinaku” 5/9 Lagja Pejton 10000 Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore për përmbushjen e borxhit. Ne pjesën II te dispozitivit e ka Hedhur poshtë si te palejuar Urdhrin Përmbartimor, i lejuar sipas propozimit për përmbartim te kreditorit “Suma Engineering Platformë” d.o.o, me seli ne rr.”Pokornoga” 9, 10000 Zagreb Republika e Kroacisë, identifikuar sipas numrit te biznesit OIB



73369220751, P.nr. 520/2019 dt.02.08.2019 nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, kundër debitorit “Bechtel Enka-GP O.P” me numër identifikues Unik 810897712, numër te biznesit 70658755 dhe numër fiskal 600455324, me seli ne rrugën “Mujo Ulqinaku”, lidhur me çështjen e përmbushjes se borxhit. Ne pjesën III te dispozitivit ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.520/2019 dt.02.08.2019, te lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha, mbi caktimin e përmbarimit për shkak te in kompetencës ne këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë kreditori përmes përfaqësuesit te autorizuar avokat Ekrem Hoxha nga Prishtina, për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës përmbarimore dhe vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ne tërësi ankesën si te bazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta prish ashtu qe çështjen ta kthej ne rivendosje, ose te marr vendim meritor.

Përgjigje ndaj ankesës se kreditorit, ka ushtruar debitori, duke e kundërshtuar ankesën e kreditorit si te pabazuar, me propozim qe gjykata e shkalles e dyte ta refuzoj te njëjtën ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

**- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Suma Engineering Platformë” d.o.o, me seli ne rr.”Pokornoga” 9, 10000 Zagreb Republika e Kroacisë, identifikuar sipas numrit te biznesit OIB 73369220751, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Bechtel Enka-GP O.P” me numër identifikues Unik 810897712, numër te biznesit 70658755 dhe numër fiskal 600455324, me seli ne rr.”: Mujo Ulqinaku” 5/9 Lagja Pejton 10000 Prishtinë, me datën 01.08.2019 , në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave-Pjesa A) me nr.005-01-2017 dt.27.05.2017, 007-01-2017 dt.27.06.2017, 009-01-2017 dt.27.07.2017, 010-01-2017 dt.27.08.2017, 012-01-2017 dt.27.09.2017, 019-01-2017 dt.27.10.2017, 026-01-2017 dt.27.11.2019, 031-01-2017 dt.27.12.2017, 005-01-2018 dt. 27.01.2018, 006-01-2018 dt.27.02.2018, 009-01-2018 dt. 27.03.2018, 013-01-2018 dt. 27.04.2018, 022-01-2018 dt. 31.05.2018, 023-01-2018 dt. 29.06.2018, 028-01-2018 dt. 26.07.2018, 031-01-2018 dt.26.08.2018, 033-01-2018 dt.30.09.2018, 035-01-2018 dt. 31.10.2018, 036-01-2018 dt. 30.11.2018 dhe Pjesa B), Faturat nr. 013-01-2017 dt.06.10.2017, 017-01-2017 dt. 28.10.2017, 018-01-2017 dt. 28.10.2017, 020-01-2017 dt. 17.11.2017, 027-01-2017 dt 05.12.2017, 028-01-2017 dt. 12.12.2017, 030-01-2017 dt. 22.12.2017, 001-01-2018 dt. 19.01.2018, 002-01-2018 dt. 30.01.2018, 003-01-2018 dt. 03.02.2018, 004-01-2018 dt. 10.02.2018, 010-01-2018 dt. 16.04.2018, 012-01-2018 dt.






19.04.2018, 014-01-2017 dt. 02.05.2018, 015-01-2018 dt.11.05.2018, 016-01-2018 dt.21.05.2018, 018-01-2018 dt.30.05.2018, 021-01-2018 dt.08.06.2018, 026-01-2018 dt. 02.07.2018, 027-01-2018 dt. 25.07.2018, 030-01-2017 dt. 28.08.2018, 034-01-2017 dt.17.10.2018 . Përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.520/19 dt.02.08.2019, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat t'i paguaj për të dy pjesët A dhe B, shumën në total prej 1,684,224.88 euro si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 07.08.2019, me pretendimin se sipas pikës 20.2 të Kontratës së lidhur me kreditorin dhe debitorin, palët janë pajtuar që të gjitha mosmarrëveshjet nga kjo kontratë të zgjidhin para Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë (Internacional Chamber of Commerce). Neni 20.2 në fakt paraqet Klauzolën e Arbitrazhit. E njëjta klauzole është kontraktuar me kreditorin dhe debitorin, në pikën 19 të Kontratës së Qiramarrjes nr. 25939-EQI-SA-SREN-00055 dt.15.01.2018, e cila është pjesë përbërëse e raporteve kontraktuese me Kreditorin dhe Debitorin e të cilën Kreditori qëllimisht e anashkalon. Neni 20 i LPK përcakton qartë se gjykata është e detyruar të shpallet jo kompetente nëse palët kanë kontraktuar Arbitrazhin, nënse nga kjo neni 17 i LPP për zbatimin e përshtatshme të dispozitave të LPK dhe nënse nga fakti se dispozitat e LPP nuk ofrojnë zgjidhje në rast se kreditori dhe debitori e kanë përzgjedhur Arbitrazhin, rrjedh përfundimi se dispozita e nenit 20 të LPK përshtatshëmrisht zbatohet edhe në rastin konkret. Propozon që gjykata ta pranojë prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor ta anuloj duke shfuqizuar të gjitha veprimet e përmbarimor të përmbaruesit privat, po ashtu të hedhet poshtë propozimi për përmbarim të kreditorit si i palejuar dhe shpenzimet e përmbarimit të bien barrë e kreditorit.

Ndaj prapësimit të debitorit, me datën 13.08.2019 ka ushtruar përgjigje kreditori, me pretendimin se faktet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk paraqesin bazë për kundërshtim konform nenit 71 të LPP. Faturat mbi të cilat është iniciuar propozimi për përmbarim plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me nenparagrafin 1.3 të nenit 29 të LPP, janë origjinale dhe janë të pranueshme nga debitori, ndërlidhur me referimin ligjor të debitorit për nenin 17 të LPP, e njëjta mund të vë në shprehje në rastet të cilat nuk parashihen me dispozitat e LPP përderisa propozimi për përmbarim, urdhri përmbarimor, obligimet e krijuara dhe moskundërshtimit brenda afateve ligjore dhe provat e bashkangjitura, të gjitha kumulativisht janë në përputhje me dispozitat ligjore - neni 37, 38, 40 të LPP, andaj edhe propozon që gjykata ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit dhe ta detyroj debitorin të paguaj borxhin së bashku me të gjitha kamatat vonesat dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.1609/19 të datës 16.12.2020, me të cilin është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, ka hedh poshtë si të palejuar urdhrin përmbarimor dhe të njëjtin e ka shfuqizuar për shkak të inkompetencës në këtë çështje përmbarimore, duke vendosur më definitivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka





theksuar se gjykata me datën 16.12.2020 ka caktuar seancë dëgjimore ku kanë prezantuar te autorizuarit e debitorit dhe kreditorit. Arsyeton se me marrëveshjen për qiranë e datës 136.12.2016 ne mes qiramarrësit Bechtel Enka Gjeneral Partnership (BEGP) dhe qiradhënësit Suima Engineering Platforme d.o.o dhe ne nenin 20 par.2 të kësaj marrëveshje palët kanë përcaktuar se “për çdo debat, mosmarrëveshje mes palëve, dallim, apo pretendim që rrjedh apo ndërlidhet me këtë marrëveshje, me shkeljen, shkelputjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht pranë Arbitrazhit Ndërkombëtar, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë dhe Industrisë në Vjenë-Austri (Internacinal Chamber of Commerce). Gjykata vlerëson se neni 20.2 i kontratës në fakt paraqet “Konkluzë të arbitrazhit”, andaj gjykata konstaton se palët me vullnetin e tyre e kanë rregulluar zgjidhjen e kontesteve eventuale duke qenë se kjo marrëveshje prodhon efekt juridik, e përjashton kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me këtë çështje përmbarimore. Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 20 par.1 të LPK dhe nenit 511 të njëjtit ligj përkitazi të drejtës e palëve që zgjidhjen e çështjes t’ia besojnë Arbitrazhit dhe faktin se në këtë rast gjykata duhet të shpallet in kompetente dhe ti anulohet veprimet e ndërmarra dhe këtë procedurë, andaj bazuar në këto arsye gjykata edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes që të shpallet in kompetente në këtë çështje. Pas analizimit të shkresave në lëndë përkatësisht Kontratën se Qirasë të cilën e kanë lidhur palët ndërgjygjese kreditori dhe debitori me datën 22.12.2016 nën numrin 25939-STI-SOSC-00045, edhe kjo gjykatë pati parasysh nenin 20.2 të kësaj marrëveshje është e paraparë se “Nëse me negociatë të tilla nuk arrihet marrëveshje, të gjitha debatet, pretendimet, mosmarrëveshjet dhe/ose dallimet e tilla duhet, me kërkesën me shkrim të njëres pale dërguar palës tjetër jo më pak se tridhjetë (30) dite kalendarike para datës së paraqitjes së një arbitrazhi, të paraqiten në arbitrazhin në përputhje me rregullat, pastaj marrjen e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Procedimet do të jenë në gjuhën angleze dhe arbitri(et) do të japin një mendim me shkrim. Vendimi i dhënë nga arbitri (et) do të jetë detyrues për palët pa ankesë/apel. Vendi i një Arbitrazhi të tillë do të jetë Vjena, Austri. Aktgjykimi mbi një vendim të tillë mund të futet në çdo gjykatë që ka juridiksion të mosmarrëveshjes ose mund të behet kërkesë në gjykatë të tillë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe një urdhër të përmbarimit, si të zgjedh pala që kërkon të zbatojë një vendim të tillë. Secila pale do të përballojë shpenzimet e veta të arbitrazhit dhe çdo kosto e paguar Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë do të ndahet në mënyrë të barabartë nga palët” dhe dispozitave ligjore nga neni 20 të LPK i cili në par.1 thotë se “Po që se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin, gjykata, të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të palës së paditur do të shpallet in kompetente, do t’i anulohet veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë”, neni 511 i cili në par.1 përcakton se “Palët mund të merren vesh që zgjidhjen e kontestit, lidhur me të drejtat me të cilat mund të disponojnë lirisht, t’ia besojnë arbitrazhit” dhe neni 514 par.1 thotë “Në qoftë se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar kompetencën e arbitrazhit, gjykata të cilës i është paraqitur padia për zgjidhjen e të njëjtit kontest dhe midis



palëve të njëjta, sipas prapësimit të paditurit shpallet jo kompetente, i anulon veprimet procedurale të kryera dhe me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme”, gjeti se gjykata e shkallës së parë të këtë vepruar dhe konform asaj që palët kanë, paraparë palët, janë dakorduar dhe e kanë rregulluar vet zgjidhjen e kontesteve eventuale.

Në rastin konkret Gjkata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjkata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë i vlerësoi pretendimet e kreditorit por të njëjtat janë irelevante për një vendosje ndryshe, ashtu që bazuar në argumentet e sipër cekura vendosi që këto pretendime të refuzoj si të pabazuara.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1387/22, me datë 17.05.2023**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami,**

